



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNES

Nr. 01-450-254046

Datë 11 OCT 2016 2016

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 110-391, dt. 25.02.2010, duke marr për bazë kërkesat e qytetarëve me gjendje të rëndë sociale dhe nevojat për sigurimin e drunjtëve djegëse për ngrohje, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi, për ndarjen e masës drusore për djegieje, e konfiskuar nga autoriteti i pyjeve dhe sektori i pylltarisë në kuadër të Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.
- II. Masa drusore sipas pikës I të këtij vendimi, do të shpërndahet për rastet me asistencë sociale dhe nevoja emergjente për ngrohje.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria Inspeksionit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
- IV. Për bartjen e masës drusore të cekur në piken II të këtij vendimi, do të kujdeset NP Hortikultura.
- V. Ky Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

VENDIMI I DËRGOHET :

- Drejtorisë Inspeksionit
- Drejtoria Sh.M.S
- Hortikultura
- Qendra për Shërbim me Qytetar



KRYETARI I KOMUNES

Slpend Ahmeti